

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE DURRËS  
ZYRA NOTERIALE ELBASAN

NR. 1564.REP NR. 719.KOL



ELBASAN Dt 19.08.2019

### KONTRATË SHITJE KUOTË AKSIONESH

Sot ne Elbasan me date 19.08.2019( Nëntëmbëdhjetë gusht dy mijë e nëntëmbëdhjetë) para meje noterit Klevis.Kosova me seli ne Lagjen 5 Maj,Rruga "Kozma Naska" prane Gjykates se Rrethit Elbasan, u paraqita personalisht përpara paleve kontraktuese:

**Agim Alikaj** i biri i Mete ,i lindur në date 19.06.1972 ne Vlorë dhe banues ne Elbasan me zotësi te plotë juridike për të vepruar e identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr 025148534 dhe Nr personal H 20619129 H I leshuar me date 29.04.2009.

**Brunilda Alikaj** e bija e Saba e lindur ne date 13.11.1977 ne Vlore dhe banuese ne Vlore e identifikuar me pasaporte me Nr BD2753474 dhe me numer personal H 76113110 M e leshuar ne date 24.08.2009 me zotesi te plote juriudike dhe per te vepruar e cila jep pelqimin sipas parashikimeve te nenit 74 dhe 90 te Kodit Familjes .Ne kryerjen e ketij veprimi juridik perfaqesohet nepermjet prokures Nr 1235 Rep dhe Nr 561 Kol date 29.06.2019 te noterit Klevis Kosova .

Ketu me poshte do te quhet shitësi I kuotës.

**Fatbardh Doko** i biri i Samiut I datëlindjes 30.06.1959 lindur ne Fier dhe banues ne Elbasan me zotësi te plotë juridike për të vepruar I identifikuar nëpërmjet leternjoftimit Nr 027989898 dhe me numër personal F 90630170 H.

Ketu me poshte do te quhen "blerësi i kuotës" nga ana tjetër.

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

#### NENI 1

#### BAZA LIGJORE

.Kodi Civil I Republikes se Shqiperise neni 850 e vijues , Ligji Nr. 110, date 20.12.2018"Per Noterine ", (I ndryshuar),ligji 9901 datë 14.08.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " e legjisclacioni I fushes ne fuqi si dhe neni 74 dhe 90 I kodit te familjes.

### OBJEKTI I KONTRATES

Objekti i kesaj kontrate eshte transferimi nepermjet blerjes nga ana e Fatbardh Doko e kuotes te perbere nga 50 % te aksioneve te shitesit Agim Alikaj ne shoqerine "DOALPAINT "SHPK me NUIS K 73206204 L e themeluar me date 17.04.2007 e regjistruar ne daten 19.04.2007 me seli ne Elbasan Kombinati Metalurgjik ne perputhje me parashikimet e statutit te shoqerise dhe akteve ligjore dhe nenligjore .

### ÇMIMI I KUOTËS

Palët ne kete kontrate duke shprehur vullnetin e tyre bien dakort se cmimi i shitjes se kuotes me pronar Agim Alikaj se perbere nga 50% te aksioneve ne kapitalin e shoqerise"DOALPAINT" shpk me NUIS K 73206204 L do te jete ne vleren 50.000 (pesëdhjetë mijë ) Lekë .

Ky çmim perfaqeson vleren e quotes se shitesit sipas vleresimit paraparak te kryer nga perfaqesuesit e bleresit.

Menyra e likuidimit te çmimit te shitjes se kuotes se perbere nga 50 % te aksioneve do te jete ne rruge bankare.

#### MENYRA LIKUIDIMIT

Bleresi i kuotes Fatbardh Doko merr persiper te likujdoje cmimin e blerjes se kuotes sipas vleres se rene dakort ,brenda ditës sotme .

#### NENI 2 KALIMI I PRONËSISË

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate nga palet pjesmarrese Fatbardh Doko fiton pronesine e kuotes se aksioneve duke u bere pronar i vetem i kuotes ne masen 100% te aksioneve.

Bleresi ka detyrimin per regjistrimin e kesaj kontrate shitblerjeje te kuotes se perbere nga 50 % e aksioneve ne Qendren Kombetare Regjistrimit sipas parashikimit te ligjit 9901 Per shoqerite tregtare dhe te ligjit Për Qendren Kombetare te Regjistrimit.Gjate periudhes se perkohshme nga momenti I nenshkrimit te kesaj kontrate shitblerje kuote aksionesh deri ne momentin e regjistrimit te kesaj kontrate dhe publikimit te saj ne regjistrin e QKR shitesi dhe bleresi pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi I kuotave .

#### NENI 3 GARANCITË E SHITËSIT

Shitesi merr persiper dhe garanton bleresin se kuotat e aksioneve ne pronesine e tij jane te transferueshme dhe palet bien dakort qe edhe barren , qe ka sherbyer si mjet tjetet apo forme garancie qe sherben per permbushjen e detyrimeve te shoqerise tek te trete te transferohet tek bleresi . Per shenimin nga Regjistri i Barreve Siguruese i regjistruar me kontraten Nr 2 Rep dhe Nr 2 Kol date 28.04.2016 te noteres Luena Tolica palet bien dakort qe do te transferohet se bashku me kufizimet dhe barren mbi kuoten tek bleresi i ri .

Shitesi garanton bleresin se nuk figuron asnje detyrim i ri ose i prapambetur ndaj te treteve qe te jete marre persiper nga ana e tij nepermjet kontratave,faturave ,apo deklarave te njeanshme me cilesine e pronarit te kuotes se aksioneve ne "DOALPAINT" shpk me NUIS K 73206204 L.Per kete qellim nga ana e shitesit ,bleresit i ofrohet garanci ne formen e shperblimit te demit te pesuar qe vjen nga fakte,apo rrethana qe bleresit nuk i jane bere me dije ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate.

Shitesi merr persiper ne cdo moment te vendose ne dispozicion te bleresit ose perfaqesuesit/ve te tij eksperte ,kontabel,juriste,avokate çdo dokumentacion te nevojshem per kete qellim.

Shitësi deklaron se si pronar i kuotes te aksioneve ne shoqerine Doalpaint shpk ka depozituar dhe paguar rregullisht dhe në kohë të gjitha tatimet, taksat, pagesa të kontributit shoqëror, kontribute të çdo lloji, zbritje apo mbajtje të çdo tipi të aplikuar në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të ardhurat, fitimet, pasuritë neto, doganat, vlerës së shtuar apo çdo referencë tjetër, në nivel kombëtar apo lokal të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

#### NENI 4 GARANCITË E BLERËSIT

Fatbardh Doko me cilesine e bleresit te kuotave te aksioneve garanton shitesin se likujdimi I cmimit te shitjes per te cilin palet bien dakort ne kete kontrate do te behet ne rruge bankare sipas parashikimeve te kesaj kontrate .

Fatbardh Doko me cilesine e bleresit te kuotave te aksioneve garanton shitesin se do te likujdoje çdo tarife ,takes,apo pagese tjeter qe do te kryhet per transkriptimin e kesaj kontrate ne QKR **me perjashtim** te tatimit mbi te ardhurat qe parashikohet ne ligjin 8438 date 28.12.1998 Per Tatimin mbi te Ardhurat I ndryshuar si dhe ne udhezimet perkatese ne zbatim te tij.(qe do te paguhet bashkerisht )

## NENI 5

### STANDARTI I KONFIDENCIALITETIT

Secila pale ne kete kontrate bie dakord ta mbajë të fshehtë çdo informacion të palës tjetër që përbën per veprimtarine tregtare te shoqerise , informacionin teknik ,profesional,tregtar konfidencial, për aq kohë sa ky informacion do të ketë vlerë tregtare dhe gjithsesi për të paktën 10 vite pas datës së mbarimit të kontratës. Palët bien dakord që informatat teknike konfidenciale te shoqerise mos I ekspozojne tek te tretet ose te operatore tregatre qe operojne ne fushen e tregtimit,prodhimit ,importimit,shitjes me pakice ose shumice te bojrave,industrial,civile etj. Por, ky obligim nuk do të jetë i zbatueshëm në qoftë se, në kohën përkatëse, informacioni është:

**A. I detyruar te zbulohet ne gjykate .**

## NENI 6


### KONFLIKTI I INTERESIT

Shitesi merr persiper gjate momentit te zbatimit te kesaj kontrate por edhe ne te ardhmen per nje afat 10 vjecar qe te shmange edhe eliminoje ne rast se gjendet ne konflikt interesi ndermjet detyres profesionale (pergatitjes se bojrave ) dhe interesave private te tij apo te personave te lidhur me te ne menyre te drejtperdrejte apo te terthorte qe mund te ndikojne ne veprimtarine e "Doalpaint " shpk te heqe dore duke mos cenuar interesat e shoqerise Doalpaint .Gjithashtu shitesi merr persiper ne te ardhmen te per nje afat 10 vjecar te mos angazhohet per veprimtari tregtare ose profesionale qe lidhen me tregtimin ,pergatitjen ,shperndarjen,apo cdo forme tjeter ne fushen dhe objektin e veprimtarise se shoqerise "DOALPAINT" shpk me NUIS K 73206204 L ne fushen e bojrave .Ky angazhim qendron ne faktin shitesi nuk do te krijojë shoqeri tjeter ne fushen e tregtimit te bojrave etj qe ka te njejtin fushe veprimi me shoqerine"DOALPAINT" me NUIS K 73206204 L ,ose me hapjen e njesive ,dyqaneve ,ose perfaqesive tregtare te shoqerive te tjera ne kete fushe te importit,dhe shitjes se bojrave,si dhe ofrimi i asistences teknike ne pergatitjen ose perpilimin e formulave per shoqeri te tjera te prodhimit edhe tregtimit te bojrave sipas objektit te veprimtarise se "DOALPAINT" me NUIS K 73206204 L .

## NENI 7

### FORCA MADHORE

Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfardolloj dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohej për shkak të forcave madhore ose rastit faktor dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, lufta, greva,



zjarre, përmbyetje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qëndror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

**NENI 8**

**INTERPRETIMI I KONTRATES**

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

**NENI 9**

**LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM**

Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit 9901 Per shoqerite tregtare si , dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

Palët bien dakort që çdo mosmarreveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë Shqipëri.

Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

**BLERËSI**

FATBARDH DOKO

*Fatbardh Doko*

*[Signature]*

**SHITËSI**

AGIM ALIKAJ

*Agim Alikaj*

Jep pëlqimin bashkëshortja

BRUNILDA ALIKAJ

Përfaqësuar me prokurë nga

AGIM ALIKAJ

*Agim Alikaj*

**NOTER**

**KLEVIS KOSOVA**

*[Signature]*

**REZULTATET E KËRKIMIT**

**INFORMACION I PËRGJITHSHËM :**

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2019081982419682  
Data e Rezultatit të Kërkimit: 19.08.2019  
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 8:24:19AM  
Lloji i Kërkimit: **Emri i Personit Juridik**  
Kriteri i Kërkimit: (EM) DOALPAINT SH.P.K.

Numri i Dokumentit: D-400-452-140  
Referenca e Përdoruesit:

**NUMRI I REZULTATEVE TE GJETURA SIPAS :**

(EM) DOALPAINT SH.P.K. **ËSHTË 1**

\*\*\*\*\* REGJISTRIMI - A-20160429162149107 \*\*\*\*\*

Data e regjistrimit: 29.04.2016  
Ora e regjistrimit: 4:21:49PM  
Kohëzgjatja e Regjistrimit (vite): 5  
Data e Përfundimit të Regjistrimit: 29.04.2021  
Numri i Dokumentit: A-319-002-214  
Referenca e Përdoruesit:

**BARRËMARRËSI (Kreditori):**

Emri i Personit Fizik/Juridik  
(EM) BANKA OTP ALBANIA/2 SH.A.

Adresa  
Adresa: BLV: DESHMORET E KOMBIT, TWIN  
TOWERS, KULLA 1, KAT K41424801U  
TIRANE-TIRANE  
SHQIPERI  
Tel: +355 4 2280442/3  
Fax: +355 4 2280441  
Email:

**Regjistri i Barrëve Siguruese**

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,  
"Selvia", Kati V  
TIRANE, SHQIPERI  
TEL/FAX: 355 4 2420005  
TEL: 355 4 2420006  
Email: rbs@roen-al.com

**BARRËDHËNËSI (Debitori):**

Emri i Personit Fizik/Juridik  
(EM) DOALPAINT SH.P.K.

Adresa

Adresa: PRANE KOMBINATIT METALURGJIK ISH  
N.M.T NR.NIPTI K73206204L  
BRADASHESHI-ELBASAN  
SHQIPERI  
Tel:  
Fax:  
Email:

**MALLRA ME NUMER SERIE:**

Nr. i Serise

Prodhuesi

Viti

**KOLATERAL PERSHKRIM:**

MBI INVENTARIN NE PRONESI TE DOALPAINT SH.P.K. NE VLEREN 140,000 EUR  
SIPAS MARREVESHJES BARRES SIGURUESE NR.2 REP DHE NR.2 KOL DATE  
28.04.2016 TE NOTERE LUENA TOLICA.

**PERSONI REGJISTRUES:**

Emri i Personit Fizik/Juridik

Adresa

Tel:  
Fax:  
Email:



**NËNSHKRIMI I AUTORIZUAR :**

Emri dhe Mbiemri

FERID SHIJAKU

**FUNDI I REGJISTRIMIT - A-20160429162149107**



*Levi Kacaj*

# Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,  
"Selvia", Kati V  
TIRANE, SHQIPERI  
TEL/FAX: 355 4 2420005  
TEL: 355 4 2420006  
Email: rbs@roen-al.com

Fundament rezultatit të sigurimit.

Fundament Dokumentit.



*Leu Kacaj*

NOTER  
E BASAN

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE DURRËS  
ZYRA E NOTERISË ELBASAN



Dt 29.06.2019

Nr. 1235 Rep  
Nr. 567 Kol

**PROKURË E POSAÇME**

Ne Elbasan , sot më datë 29 / 06 / 2019 (qershor dymijë e nentëmbëdhjetë ), para meje noterit Klevis Q.KOSOVA anëtar I Dhomës së Noterisë DURRËS me seli në LAGJA "5 Maj" Rruga "Kozma Naska", Elbasan u paraqit personalisht :

**E PËRFAQËSUARA**

Brunilda Alikaj e bija e Saba e lindur ne date 13.11.1977 ne Vlore dhe banuese ne Vlore e identifikuar me pasaporte me Nr BD2753474 dhe me numer personal H 76113110 M e leshuar ne date 24.08.2009 me zotesi te plote juriudike dhe per te vepruar

*E cila me cilesine edhe te bashkeshortes se Agim Alikaj më kërkoi redaktimin e një*

**PROKURË TE POSAÇME**

Bazuar ne nenin 64-78 te Kodit Civil

Si me poshte vijon:

Unë e nënshkruara Brunilda Alikaj me anë te kësaj prokure emëroj si përfaqësuesin tim të posaçem z **Agim Alikaj** I biri i Mete ,i lindur në date 19.06.1972 ne Vlorë dhe banues ne Elbasan me zotësi te plotë juridike për të vepruar e identifikuar nëpërmjet pasaportes Nr BD 2753487 dhe Nr personal H 20619129 H I leshuar me date 24.08.2009 shtetas shqiptare me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

I cili ka te drejte qe në emër dhe për llogarine time personale si individ te përmbushe këto tagra:

Përfaqësuesi i zgjedhur me anë te këtij akti përfaqësimi, në mënyrë te shprehur ka tagër **përfaqësimi** për te më përfaqësuar pranë:

Prane çdo zyre noterie per te nenshkruar cdo lloj akti noterial kontrate dhurimi, kontrate shitje per shitjen e kuotes se aksioneve qe ka ne pronesi bashkeshorti im ne shoqerine "DOALPAIN " sh.p.k e themeluar me datë 17.04.2017 duke e vendosur vete çmimin e shitjes dhe menyren e likujdimit pa asnjë kufizim,

*Alikaj*



Kjo prokurë lëshohet për një periudhe kohe te pakufizuar deri ne përmbushjen e qëllimit për te cilin është lëshuar dhe per sa kohe nuk është revokuar me nje akt te dytë te te njëjtës formë sipas përcaktimeve te nenit 76 te Kodit Civil.

Ky akt u mbajt ne kater kopje dhe unë noteri Klevis Q.Kosova pasi u binda per identitetin e paleve te cilet me konfirmuan se e lexuan dhe kuptuan permbajtjen e aktit e legalizoj aktin sipas nenit 63 të ligjit 110 dt 20.12.2018 " Për noterinë".

E PËRFAQËSUARA

**BRUNILDA ALIKAJ**

*Alikaj Brunilda*  
*Alikaj*

NOTER

**KLEVIS KOSOVA**

*Kosova*

